



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dërguar / Prijeto / Pristalo / Received / Dostupno	05. 08 2022	viti / god / year	
Organ / Njësia / Organ / Jedinstvo / Org. / Unit	Nr. Pjesë / in Pjesë / Part. No.	Shtesa / Prllog / Annexa	Sasia / Kufizimi / Quantity
SK/10/11/11	4577/2022		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.513/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.513/2022 të datës 08.06.2022 të parashtruar nga ankuesit dhe kundër Vendimit me numër protokolli Nr.733/2022 të datës 22.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.513/2022 e datës 08.06.2022 e parashtruar nga ankuesit dhe lidhur me kompensimin e pagave të ndaluara të ankuesve për muajin shkurt, mars dhe prill të vitit 2022, si dhe Obligohet personi përgjegjës në Inspektoratin e Punës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e pagave të ndaluara të ankuesve për muajin shkurt, mars dhe prill të vitit 2022, se bashku me detyrimet ligjore të zbatueshme lidhur me pagat (kontributet pensionale dhe detyrimet tatimore).
- II. Refuzohet pretendimi ankimor i ankuesve për anulimin e Vendimit me numër protokolli Nr.733/2022 të datës 22.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, dhe i njëjti vërtetohet.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesit dhe të punësuar në Inspektoratin e Punës, më datë 08.06.2022 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 3327/2022 në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e plotësuar me datë 10.06.2022, për kompensimin e pagave të ndaluara të ankuesve për muajin shkurt, mars dhe prill të vitit 2022, dhe anulimin e Vendimit me numër protokoll 733/2022 të datës 22.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesve në Inspektoratin e Punës, ndërsa ky i fundit më datë 29.06.2022 ka përcjell shkresat lidhur këtë çështje ankimore.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më kërkesë të Kryetares së kolegjit më datë 14.07.2022, ka nxjerr Vendimin me numër VK.nr.67/2022 për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës së ankuesve për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3327/2022 të regjistruar me numër A.nr.513/2022 e datës 08.06.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.733/2022 të datës 22.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës; Emailin e datës 23.05.2022; Plotësimin e ankesës të datës 10.06.2022; Raporti Zyrtar i Inspektimit i datës 17.05.2022; Raport Zyrtar i Inspektimit me numër 02.Nr.01/2022 për Shtëpinë e Shëndetit Mitrovica e Veriut; Raport Zyrtar i Inspektimit me numër 02.Nr.02/2022 për Barnatore në Mitrovicën e Veriut; Raport Zyrtar i Inspektimit me numër 02.Nr.04/2022 për Moç prirode SHPK; Raport zyrtar/Inspektim 02.Nr.13/2022 të datës 17.05.2022; Certifikatë e regjistrimit të biznesit 811122887e datës 11.04.2014; Raport zyrtar/Inspektim 02 Nr.05/2022 të datës 08.02.2022; Certifikatë e regjistrimit të biznesit 811429671 e datës 18.06.2020; Raport zyrtar/Inspektim 02.Nr.06/2022 të datës 09.02.2022 në Barnatore Raport zyrtar/inspektim 02.Nr. 07/2022 të datës 14.02.2021 në Poliklinikë

Certifikatë e regjistrimit të biznesit 811165473 e datës 16.12.2014 Poliklinikë Raport zyrtar/Inspektim 02.Nr.10/2022 në Subjektin afarist Raport zyrtar/Inspektim 02.Nr.09/2022 të datës 07.03.2022 në barnatore Raport zyrtar/Inspektim 02.Nr.12/2022 të datës 06.04.2022 në subjektin afarist Regjistri i ardhjes dhe shkuarjes nga puna për muajin janar 2022 datat 04.01.2022, 05.01.2022, 06.01.2022, 07.01.2022; Raport zyrtar/inspektim 02.Nr.12/2022 të datës 06.04.2022 në subjektin afarist Certifikata e regjistrimit 810702937 të datës 11.02.2016 për Certifikatë-Deklarues i TVSH numër 330346305 për

Raport zyrtar/inspektim 02.Nr.14.2022 të datës 24.03.2022; Certifikatë e regjistrimit të biznesit 80332734 të datës 20.11.2000 data e inkorporimit 18.03.2015; Letërnjoftimi e i lindur më 24.02.1963; Certifikat -Import dhe eksport numër 330130378 me datën e regjistrimit 24.08.2001; Informata mbi biznesin me numrin e biznesit 80332734- data e konstituimit 18.03.2015; Akt emërim të datës 05.01.2016 për Akt emërim për të datës 05.01.2016; Akt emërim për

të datës 05.01.2016; Regjistri i ardhjes dhe shkuarjes nga puna të datës 17.03.2022 për ankuesit; Regjistri i ardhjes dhe shkuarjes nga puna të ankuesve të datës 25.03.2022, 24.03.2022, 02.03.2022, 21.03.2022, 10.03.2022, 30.03.2022, 01.03.2022, 08.03.2022, 09.03.202, 11.03.2022, 29.03.2022, 24.03.2022, 22.03.2022, 07.03.2022, 23.03.2022, 03.03.202, 15.03.2022, 28.03.2022, 16.03.2022, 01.02.2022, 14.03.2022, 02.02.2022, 03.02.2022, 04.02.2022, 08.02.2022, 09.02.2022, 07.02.2022, 10.02.2022, 11.02.2022, 15.02.2022, 16.02.2022, 21.02.2022, 22.02.2022, 23.02.2022 24.02.2022, 28.02.2022, 10.01.2022, 11.01.2022,

12.01.2022, 13.01.2022, 14.01.2022, 17.01.2022, 18.01.2022, 19.01.2022, 20.01.2022, 21.01.2022, 24.01.2022, 25.01.2022, 26.01.2022, 27.01.2022, 28.01.2022, 31.01.2022, 04.04.2022, 04.05.2022, 07.04.2022, 08.04.2022, 11.04.2022, 12.04.2022, 13.04.2022, 14.04.2022, 15.04.2022, 19.04.2022, 20.04.2022, 21.04.2022, 22.04.2022, 26.04.2022, 27.04.2022, 28.04.2022, 29.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.06.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 29.06.2022; Përshkrimin e detyrave të Punës për Inspektor i Punës; Kërkesë për hapjen e procedurës disiplinore ndaj ankuesve e datës 04.04.2022; Emailin e datës 31.01.2022 dhe 24.02.2022 nga [redacted] për kërkesë për Komisionin Disiplinor; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 15.04.2022; Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit Disiplinor i datës 08.04.2022, 07.04.2022; Njoftim i datës 06.04.2022 për ankuesit; Vendimin VK.nr.67/2022 i datës 14.07.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ftesë për seancë publike e datës 15.07.2022 për ankuesin dhe Inspektoratin e Punës; Provat e dorëzuar më datë 28.07.2022; Regjistri i ardhjes dhe shkuarjes nga puna të datës 01.07.2022, 04.07.2022, 05.07.2022, 06.07.2022, 07.07.2022, 08.07.2022, 12.07.2022, 13.07.2022, 14.07.2022, 18.07.2022, 19.07.2022, 20.07.2022, 21.07.2022, 22.07.2022 për ankuesit; Urdhëresë për dërgimin e raportit e datës 04.05.2022 nga [redacted] për ankuesit; Formën e raportimit e dërguar më datë 29.04.2022 nga [redacted] për ankuesit; Urdhëresën e punës e dërguar përmes emailit të datës 27.04.2022 për ankuesit nga [redacted] Urdhëresë e dërguar përmes emailit të datës 30.05.2022, 06.07.2022 nga [redacted] për ankuesit; Kërkesën e datës 19.05.2022 nga [redacted] për ankuesit përmes emailit; Kërkesën përmes emailit të datës 18.05.2022 nga [redacted] Kërkesën për konfirmim të emailit nga [redacted] për ankuesin [redacted] Kërkesë për konfirmim të emailit e datës 10.05.2022 nga [redacted] për ankuesit; Emailin e datës 10.05.2022 nga ankuesi [redacted] për [redacted] Njoftimin e datës 26.05.2022 nga [redacted] për ankuesin [redacted] Emailin e datës 25.05.2022 nga ankuesi [redacted] për [redacted] Raportin mujor i datës 11.05.2022 nga [redacted] Emailin e datës 16.05.2022 nga [redacted] për ankuesit; Emailin e datës 16.05.2022 nga [redacted] Emailin e datës 29.04.2022 nga [redacted] Emailin e datës 04.05.2022 nga [redacted] për ankuesit; Emailin e datës 06.07.2022 nga [redacted] për ankuesin për përdorim të SIMBNJ; Njoftimin e datës 04.07.2022 nga [redacted] Emailin e datës 04.07.2022 nga info.dmzp; Kërkesën përmes emailit e datës 14.07.2022 nga [redacted] për ankuesit; Emailin e datës 04.05.2022 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 04.05.2022 nga ankuesi [redacted] për [redacted] Emailin e datës 15.07.2022, 02.06.2022 nga [redacted] për ankuesit; Emailin e datës 02.06.2022 nga ankuesi [redacted] për [redacted] Emailin e datës 11.03.2022 nga [redacted] për ankuesit lidhur me formën e raportimit mujor; Shkresë për ankuesit nga [redacted] kërkesën për Deklarimin me zero ore punë në sistemin e pagave për ankuesit e datës 07.02.2022; Procesverbalin e Seancës i datës 28.07.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa A.nr.513/2022 e datës 29.04.2022 është pjesërisht e bazuara, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale gjegjësisht sipas Akteve të Emërimeve me numër protokolli 383 të datës 29.12.2015, 384 të datës 29.12.2015 dhe 385 të datës 29.12.2015, ankuesit janë të emëruar dhe ushtrojnë detyrën e Inspektorit të Punës në Inspektoratin e Punës-Drejtoria Rajonale në Mitrovicë. Me tej, nga vlerësimi i prova materiale Kolegji ka gjetur se Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesve në cilësi të Udhëheqësit të Divizionit për Koordinim Rajonal në Rajonin e Mitrovicës, më datë 31.01.2022 ka parashtruar kërkesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës për deklaram të pagës më zero (0) dhe kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesve, me pretendimet se të njëjtit nuk janë duke i kryer detyrat e punës, nuk zbatojnë urdhëresat e punës dhe planin e punës si dhe nuk zbatojnë ligjet e Republikës së Kosovës. Ndërsa Menaxheri i Personelit të Inspektoratit të

Punës përmes shkresës me numër protokolli 198 të datës 07.02.2022, ka aprovuar kërkesën e datës 31.01.2022 që ankuesit të deklarohen me pagë zero në sistemin e pagave deri në një vendim tjetër, ku sipas shkresave të lëndës ankuesit nuk kanë realizuar pagë për muajin shkurt, mars dhe prill 2022.

Pas mos veprimit sipas kërkesës së datës 31.01.2022, Udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesve serish me datë 24.02.2022 paraqet kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesve po me bazë të njëjtë të shkeljeve, kurse Menaxheri i Njesisë së Personelit me datë 04.04.2022 ka përcjell pranë Komisionit Disiplinor kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesve.

Komisioni Disiplinor më datë 22.04.2022 me Vendim me numër protokolli 733, ka shpallur ankuesit përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë duke shqiptuar masën disiplinore *"ndalimi 40% i pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj"*.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në seancën dëgjimore të datës 28.07.2022, pretendojnë së ndalimi i pagës për muajin shkurt, mars dhe prill të vitit 2022, nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe Vendimi me numër protokolli 733/2022 i datës 22.04.2022 i Komisionit Disiplinor të Inspektoratit të Punës është nxjerr për shkak të vërtetimit jo të drejtë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe në kundërshtim me ligjin që rregullon të drejtat dhe detyrime si dhe përgjegjësinë disiplinore të zyrtarëve publikë. Më tej theksojnë së të njëjtit nuk kanë kushte për të kryere detyrat e tyre siç janë printerët dhe veturat zyrtare dhe se po ashtu ndihen të rrezikuar në ushtrimin e detyrave të punës, propozojnë që Këshilli të aprovoj si të bazuar ankesën, të detyroj Inspektoratin e Punës që t'i kompensoj pagat e pa paguara për muajin shkurt, mars dhe prill dhe të anulohet Vendimi me numër protokolli 733/2022 i datës 22.04.2022 i Komisionit Disiplinor.

Udhëheqësi i ankuesit në seancën dëgjimore ka deklaruar që ankuesit posedojnë zyrë, kompjuter, email zyrtar, ndërsa sa i përketë veturës zyrtare me kërkesë mund ta marrin në zyrën në çdo kohë, mirëpo të njëjtit nuk kanë shfrytëzuar veturën zyrtare për faktin që nuk kryejnë asnjë punë dhe asnjë inspektim dhe nuk kanë shqiptuar asnjë gjobë, nuk përgatisin raportet javore, mujore apo edhe vjetore rrjedhimisht nuk i përmbushin detyrat e punës për të cilën kanë akt emërim dhe paguhen.

Përkitazi me pretendimin ankimor për kompensimin e pagave për muajin shkurt, mars dhe prill 2022, Kolegji ka analizuar nenin 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave, si dhe nenin 3 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e nëpunësve civil ku theksohet se : E drejta për marrjen e pagës së rregullt mund të pezullohet vetëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në Ligjin e Shërbimit Civil dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke marr parasysh bazën mbi të cilën është bërë pezullimi/ndalimi i kompensimit pagës së ankuesve, Kolegji i Këshillit vlerëson se mos përmbushja e detyrave të punës konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore siç është konstatuar me lartë, dhe se e drejta në pagë mund të kufizohet vetëm në rast së shkelja disiplinore është vërtetuar nga organi kompetent respektivisht Komisioni Disiplinor, e që në rastin konkret pezullimi/ndalimi i kompensimit pagës së ankuesve është bazuar vetëm në kërkesën e udhëheqësit të ankuesit, andaj, mbi këtë bazë ligjore rezulton se është i bazuar pretendimi ankimor i ankuesve, kështu që mbi këto arsye Kolegji i Këshillit vendosi si në piken I të dispozitivit.*

Ndërsa, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore për anulimin e Vendimit me numër protokolli 733/2022 të datës 22.04.2022 të Komisionit Disiplinor, Kolegji i Këshillit i'u referua

nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".* Ndërlidhur me këtë, neni 46 paragrafi 3 i po këtij ligji, si shkelje të rënda të detyrave të punës ka përcaktuar: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë".

Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke marrë parasysh provat e ofruara lidhur me periudhën deri në vendosje lidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit sipas vendimit të kundërshtuar me ankesë, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesit nuk kanë arritur që të dëshmojnë përmbushje të rregullt të detyrave dhe përgjegjësi të punës dhe se të njëjtit nuk posedojnë evidencë mbi raportimin e punëve në baza javore, mujore dhe vjetore, përkatësisht ankuesit në raport me përmbushjen e detyrave të punës kanë prezantuar si dëshmi vetëm për muajin shkurt 2022 ku kanë kryer shtatë inspektime të evidentuara sipas raporteve zyrtare të inspektimit: Nr.02.Nr.01/2022 të datës 02.02.2022, Nr.02.Nr.02/2022 të datës 03.02.2022, Nr.02.Nr.03/2022, 02.Nr.04/2022 të datës 07.02.2022, 02.Nr.05/2022 të datës 08.02.2022, 02.Nr.06/2022 të datës 09.02.2022, dhe 02.Nr.07/2022 të datës 14.02.2021, dhe për muajin mars ankuesit ofrojnë dëshmi për vetëm tri inspektime të kryera sipas raporteve zyrtare: 02.Nr.09/2022 të datës 07.03.2022, 02.Nr.10/2022 dhe 02.Nr.14/2022 të datës 24.03.2022, kurse për periudhat paraprahe nuk ka dëshmi për kryerje të inspektimeve, e mbi bazën e këtyre fakteve, Këshilli vlerëson se mos kryerja e detyrave të punës, duke marrë për bazë edhe urdhëresat e punës të përcjella nga udhëheqësi i ankuesve bie ndesh me nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: 2. *Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës.* 3. *Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike".* Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështja disiplinore ka cilësuar drejt veprimet e ankuesve si shkelje e rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nen paragrafi 3.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që vendosi për refuzimin e pretendimit ankimor si të pabazuar dhe lënien në fuqi të Vendimit me numër protokoll 733/2022 të datës 22.04.2022 të Komisionit Disiplinor.

Për vendosje meritore Kolegji i Këshillit ju referua edhe nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe rrjedhimisht konstatoi se institucionet publike janë të obliguar që të ofrojnë kushte të nevojshme dhe të përshtatshme të punës për nëpunësit civilë, e që janë në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi të tyre.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.513/2022

Avdyl BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesve
- Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

